



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORE

Nr. 152 Prot (S.D.)

Vlore 03.03.2015

Lenda: Dergohet urdher ekzekutimi.

DREJTUAR:

DREJTORISE SE POLICISE SE QARKUT
Sektorit te kartoteke-kerkimit
V L O R E

AGJENSISE SE KTHIMIT DHE KOMPESIMIT TE PRONAVE
T I R A N E

Z.V .R.P.P-se
V L O R E

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
K A N C E L A R I S E
V L O R E

ZYRES SE AVOKATITI TE SHTETIT
T I R A N E

ZYRES PERMBARIMORE
V L O R E

Per dijeni :

Shtetasit: Mihail Rrapaj
Lagjia: "Kushtrimi", Rr: "Mehmet Pash Derrala", banese private
V L O R E

Bashkelidhur ju dergojme urdherin nr.111, date 27.02.2015 " Per ekzekutimin e vendimit penal te formes se prere nr.366 date 08.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

DREJTUESI I PROKURORISE
RAMADAN TROCI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORE

URDHER
Nr. 111 Date 27.02.2015

PER EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR. 366 DATE 08.07.2014
TE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE VLORE

Ne Vlore sot me date 27.02.2015, Une, Skender Dautaj, Prokuror ne Prokurorine Prane Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, pasi u njoha me vendimin penal nr. 366 date 08.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore me te denuarin Mihail Rrapaj, atesia Muharrem, amesia Kate, i vitlindjes 02.05.1957, lindur dhe banues ne Lagjen " Kushtrimi ", Rruga: "Mehmet Pashe Derrala", banese private, te bashkise Vlore, hetuar dhe gjykuar me mase sigurimi " arrest ne burg" ne mungese mbrojtur me av. Edmond Demaj, derguar me shkresen date 27.02.2015, dhe:

Konstatova

1..Me vendimin penal nr. 366 date 08.07.2014 Gjykata e Shkalles se Pare Vlore ka vendosur deklarimin e fajshem te te pandehurit Mihail Rrapaj per kryerjen e vepres penale te parashikuar nga neni 287/1/a,b,dh te Kodit Penal dhe denimin e tij me me 6 (gjashte) vite burgim.

2.Gjykata ka urdheruar qe vuajtja e denimit te filloj nga dita e ekzekutimit te vendimit penal te formes se prere dhe te kryhet ne burgun e sigurise se zakonshem.

3..Gjykata ne zbatim te nenit 391/1 te Kodit Pr. Penale deklaroi te falsifikuara dhe urdheron asgjesimin e dokumentave te sekuestruara sa me poshte :

1.Vendimi nr. 298, date 15.10.1996 te ish KKKP Vlore, bashkelidhur planimetria e vendosjes se prones ne emer te ketij komisioni, mbi bazen e te cilave jane regjistruar pasurite e paluajtshme nr. 410/5, zona kadastrale, si dhe ajo me nr. 1316 nr. 410/3, zona kadastrale nr. 2142 si dhe aktet e regjistrimit te ketyre pasurive.

2.Vendimi nr. 75, date 21.03.1995 te K.K.K.P. Vlore, planimetria perkatese e truallit qe shoqeron kete vendim, mbi bazen e te cilit eshte rregjistruar pasuria e paluajtshme nr. 19/169, zona kadastrale nr 8604 si dhe aktet e regjistrimit te kesaj pasurie.

3.Prokure e pergjithshme nr. 360 Rep dhe nr. 223 Kol, date 12.02.2008 ne emer te Jorgji Anastasiadhi,

4.Kontrate shitje nr. 2500 Rep dhe nr. 9491 Kol, date 24.06.2009 e lidhur midis shtetaseve Xhuljeta Anastasiadhi dhe Agim Allushi, per shitjen e pasurise nr. 19/169, zona kadastrale nr. 8604.

4..Gjykata ne zbatim te nenit 36/1/b te Kodit Penal, urdheron te konfiskohen dhe kalojne ne favor te shtetit, duke urdheruar fshirjen e regjistrimeve ne regjistrat e pasurive te palujtshme dhe regjistrimin ne favor te shtetit, si produkte te vepres penale te falsifikimit te dokumentave, te cilat jane nen masen e sigurimit te sekuestratos preventive dhe konkretisht :

1.Pasuria me nr. 410/5, zona kadastrale nr. 1316 e llojit kullote, me siperfaqe 87.634 m2 e ndodhur ne fshatin Bunavi, komuna Shushice, Vlore.

2.Pasuria me nr. 410/3, zona kadastrale nr. 2142 e llojit kullote, me siperfaqe 12.366 m2 e ndodhur ne fshatin Kerkove, komuna Qender, Vlore.

3.Pasuria me nr. 19/169, zona kadastrale nr. 8604 e llojit trualle, me siperfaqe 2.185 m2 e ndodhur ne lagjen " 24 Maji " te bashkise Vlore.

5..Gjykata ne zbatim te nenit 190/1/ç te Kodit Pr. Penale urdheron qe dokumentet e tjera te sekuestruara me urdherin e prokurorit date 17.06.2013 per bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqesor, tju kthehen personave qe ju jane sekuestruar sipas proces verbaleve perkatese te sekuestrimit.

6..Gjykata ka urdheruar qe shpenzimet gjyqesore ne shumen 36.500 leke ne ngarkim te te pandehureve.

Vendimi penal nr. 366, date 08.07.2014 i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore eshte bere i formes se prere me vendimin nr. 67, date 04.02.2015 te Gjykates se Apelit Vlore.

Sa me siper, dhe bazuar ne nenet 462,464, 465, 486/1 te Kodit te Pr.Penale, nenet 12, 17, 22 e 23 te ligjit nr 8331, date 21.04.1998 "Per ekzekutimin e vendimeve penale" :

URDHEROJ

1. Ekzekutimin e vendimit nr. 366, date 08.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, bere formes se prere me vendimin nr. 67, date 04.02.2015 te Gjykates se Apelit Vlore me te denuarin Mihal Muharrem Rrapaj per vuajtjen e denimit me burgim, disponimin per provat materiale dhe pagimin e shpenzimeve gjyqesore.

2. Per zbatimin per (pika 1, 2) te ketij vendimi per arrestimin dhe transportimin e te denuarit ne institucionin e ekzekutimit te vendimit penal ngarkohet sektori i kerkimit prane Drejtorise se Policise se Qarkut Vlore.

3. Lidhur me zbatimin per piken 3 te ketij vendimi ate te asgjesimit te dokumentave te sekuestruar ngarkohet Kancelaria e Gjykates se Shkalles se Pare Vlore dhe Angjensia e kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane.

4. Lidhur me zbatimin per piken 4 te ketij vendimi ate te kalimit dhe regjistrimit ne pronesi te shtetit te pasurive te konfiskuara ngarkohet Z.V.R.P.P. Vlore.

5. Lidhur me zbatimin per piken 5 te ketij vendimi ate te kthimit te dokumentacionit te sekuestruar me urdherin e dates 17.06.2013 personave qe ju jane sekuestruar ngarkohet Kancelaria e Gjykates se Shkalles se Pare Vlore.

6. Per zbatimin e per (pika 3, 4, 5) te ketij vendimi ngarkohet Zyra e Avokatit te Shtetit Tirane.

7. Per zbatimin e ketij urdherimi te pikes 6 te ketij vendimi ngarkohet Zyra Permbarimore Vlore.

8. Me kete urdher te vihet ne dijeni i denuari si dhe Gjykata e Shkalles se Pare Vlore.

9. Per zbatimin e ketij urdherimi te njoftohet me shkrim Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Vlore.

PROKUROR
SKENDER DAUTAJ

